

BOTIMET E SEKSIONIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS, promovimet më 18.03.2015  
(e mërkurë)

Akademik Fejzullah Krasniqi, sekretar i SSHN

### **1. Minir Dushi: ‘Boksitet e Dukagjinit’**

Boksitet janë lëndë e parë minerale me përpunimin industrial të cilave përfitohet alumini si metal shumë i rëndësishëm në teknike.

Siç dihet në jugperëndim nga Klina në serinë e sedimenteve të Kretakut të Sipërm të Malit të Gremnikut dhe rrethinës së tij, ndodhen vendburime të rëndësishme ekonomike të boksiteve. Këtu shfaqet boksiti në një strukturë faciale të gjatë rreth 15 km dhe e gjerë 0.5 – 3.5 km, e cila fillon nga fshati Lug në veri dhe përfundon në jug në fshatin Kështjellë që përfshin një sipërfaqe rreth 15 km<sup>2</sup>. Në këtë strukturë faciale në boshllëqet stratigrafike ndërmjet gëlqerorëve të turnanionit dhe atyre mastrite të kretakut ndodhen grumbullime të trupave minerale të boksiteve. Këto boksite eolitike me ngjyrë të kuqe janë të llojit diasporis dhe kryesisht ato janë me përbërje kimike: Aluminoksidi 46,52 %, silicijum oksidi 1,5 – 4,0 dhe okside të hekurit 30 – 40 %. Për shkak të përmbajtjes së lartë të hekurit janë quajtur edhe boksite feroze.

Në vitin 1966 është hapur Miniera e Boksitit “Kosova” me prodhim vjetor 100 000 tona që është shitur kryesisht në Rumani. Rezervat e boksitit janë 7 000 000 t të kategorive A, B dhe C1 që përfshihen brenda 60 trupave minerale (vendburime).

Kjo vepër shkencore shoqërohet me harta vështruese gjeologjike, profile gjeologjike, tabela, skica, skema, fotografi e materiale të tjera që e bëjnë këtë vepër të kompletuar dhe me mundësi të shfrytëzimit të këtyre hulumtimeve shkencore edhe në rrafshin aplikativ.

Me botimin e kësaj vepre shkencore, opinionit kosovar dhe më gjerë i ofrohet një studim i rëndësishëm e me vlerë ekonomike të pasurive minerale siç janë boksitet e Republikës së Kosovës.

### **2. Nexhat Daci, Majlida Daci-Ajvazi: “ Shkenca e mjedisit-zhvillim i qëndrueshëm”**

Shkenca e mjedisit është e përbërë nga një grup shkencash që tentojnë të sqarojnë ekzistimin e jetës në tokë, problemet mjedisore si edhe zgjidhjen e tyre. Ajo në të vërtetë është si një mesfazë ndërmjet njerëzve dhe tokës që i hulumton bashkëveprimet dhe relacionet midis tyre. Kështu, qasja e shkencës së mjedisit është e natyrës interdisiplinare.

Në këtë vepër janë shtjelluar në mënyrë kronologjike fenomenet dhe definicionet e përgjithshme në shkencën e mjedisit deri te komponentët specifike dhe të veçanta të sajë. Definicionet e fenomeneve në shkencën e mjedisit, bazat teorike të mjedisit, pasojat nga sistemet vepruese si edhe zgjidhjet e mundshme të tyre janë studiuar qartë edhe përkundër kompleksitetit të shkencës së mjedisit.

Duhet theksuar se në këtë vepër është bërë interpretim i duhur i çështjeve teorike, shpjegimi i fenomeneve të caktuara në mjedis, analiza e përbërësve të mjedisit , interpretimi i

mekanizmit të reaksioneve, ndikimi i ndotësve në mjedis, masat e parandalimit dhe parashikimet e shkencës së mjedisit në kushtet aktuale dhe në perspektivë.

Nisur nga fakti se kjo vepër bazohet në literaturën shkencore botërore të viteve më të fundit si dhe në rezultatet e hulumtimeve origjinale shkencore të autorëve në këtë fushë, rezultatet e hulumtimeve të paraqitura në këtë vepër janë të besueshme dhe të qëndrueshme. Duhet theksuar se një vepër e tillë i ka munguar literaturës dhe studiuesve të mjedisit në Kosovë dhe më gjerë. Si vepër e shkencës së mjedisit e kompletuar dhe bashkëkohore mund të shfrytëzohet si udhërrëfyes për hulumtimet shkencore nga kjo lëmi.

### **3. Fejzullah Krasniqi: “Termoelektrocentralet e Kosovës”**

Qëllimi i kësaj vepre është që t’i ofrohet opinionit kosovar dhe opinionit më të gjerë një studim për termoelektrocentralet e Kosovës si gjigant gjenerues i energjisë nga linjiti i Kosovës. Këtu jepen analizat e plota energjetike dhe eksergjetike të cikleve të punës që realizohet në TEC dhe analizohen deri në hollësi metodat për shtimin e punës së dobishme mekanike e cila mund të merret nga këto cikle të punës.

Në këtë vepër gjithashtu analizohen edhe kushtet për ndërtimin e TEC të reja sa i përket terrenit dhe të furnizimit me ujë dhe të furnizimit me lëndë djegëse të cilat janë përcaktuese për projektimin dhe ndërtimin e një TEC.

Përveq shqyrtimeve teorike të cikleve të punës që realizohen në pesë blloqet termoelektrocentraleve Kosova A dhe në dy blloqet e TEC Kosova B, këtu për secilin bllok përfshihen analizat e pajisjeve përbërëse të tij siç janë gjeneratori i avullit, turbina, kondensatori si dhe pajisjet dhe sistemet ndihmëse të TEC siç janë sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i furnizimit me lëndë djegëse, sistemi për filtrimin e gazrave dalëse në ambient si dhe sistemi për largimin e hirit dhe të zgjyrës nga TEC. Meqë në Kosovë është krijuar një përvojë e caktuar profesionale e punës, e shfrytëzimit dhe e prodhimit të energjisë elektrike nga termoelektrocentralet me tendenca praktike për rritjen e rendimentit të tyre të përgjithshëm, një vepër e tillë, pa dyshim se është një ndihmesë për formimin teorik dhe praktik të specialistëve të kësaj fushe në Kosovë dhe më gjerë me mundësi të shfrytëzimit edhe në rrafshin aplikativ.

### **4. Qamil Haxhibeqiri: “Hapësirat metrike”**

Hapësirat metrike dhe topologjia në shkallën më të lartë të mundshme mundësojnë sintezën e disiplinave të ndryshme shkencore matematike siç janë analiza reale, analiza funksionale, teoria e funksioneve, etj. Andaj, studimi i hapësirave të tilla paraqet një interes të posaçëm për matematikën në përgjithësi dhe për disiplinat shkencore të cekura në veçanti.

Kuptimet e vazhdueshmërisë së funksionit, konvergjencës së vargjeve, limitit, derivatit, integralit të një funksioni real, varen kryesisht nga largesa e numrave realë që përkufizohet si vlerë absolute e ndryshimit të tyre. Nëse në ndonjë bashkësi të çfarëdoshme mund të përkufizohet kuptimi i largesës së çdo dy pikave të saj që i ka vetitë e ngjashme me ato të vlerës absolute të numrave realë, atëherë kuptimet e mësipërme mund të përgjithësohen edhe për vargjet dhe funksionet e bashkësive të tilla. Në dhjetë kapitujt e këtij libri krahas

përkufizimit të hapësirës metrike, janë studiuar veprimet me hapësira metrike, disa kuptime metrike si dhe struktura topologjike e hapësirave të tilla. Konvergjenca e vargjeve të hapësirave metrike, hapësirat e plota metrike, karakterizime të ndryshme të hapësirave të tilla, teorema e Banahut mbi pikën fikse si dhe disa zbatime të saj janë objekt shqyrtimi në këtë vepër ndërsa kompaktësia dhe lidhshmëria e hapësirave metrike dhe atyre topologjike zënë vend qendrorë në këtë libër.

Në librin “Hapësirat metrike” autori tërë materien e ka shtjelluar me rigorozitetin e duhur matematikor, duke krijuar ndërlidhje të qartë në mes kuptimeve që paraqiten, pohimeve dhe teoremave relevante që vlejné për ato kuptime dhe ilustrimeve me shembuj që i bëjnë këto kuptime dhe pohime më të afërta dhe më të qarta për nje rreth më të gjerë të lexuesve.

## **5. Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm (Konferencë shkencore)**

Në botimin e veçantë të ASHAK-ut „Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm” janë përfshi kontributet shkencore të referuar në Konferencën shkencore me këtë titull të organizuar nga Seksioni i SHN e cila është mbajtur më 30 Tetor 2013 në mjediset e Akademisë . Përgatitja e Konferencës, e programit dhe agjendës së saj janë bërë nëpërmjet një procesi të bashkëpunimi dhe bashkërendimi, si dhe kontaktesh direkte ndërmjet pjesëtarëve të Këshillit shkencor organizativ me eksperte dhe drejtuesit e niveleve të ndryshme të institucioneve dhe subjekteve përgjegjëse dhe pjesëmarrëse në veprimtaritë e sektorit energjetik. Kjo edhe ishte arsyeja që në këtë Konferencë pati një pjesëmarrje prej mbi 150 specialistësh të sektorit energjetik nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Anglia.

Ne punimet e botuara në këtë përmbledhje të punimeve trajtohen problemet e diversifikimit të burimeve energjetike për një furnizim të sigurt me produkte energjetike, problemet e përmirësimit të efijencës së energjisë dhe shfrytëzimit gjithmonë e më të madh të burimeve të ripërtëritshme si dhe problemet e ruajtjes së mjedisit, duke ndërtuar dhe implementuar një kuadër ligjor dhe institucional në përputhje me Direktivat dhe standardet e BE në këtë fushë në funksion të garantimit të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të plotësimi të kriterëve të integritetit të Kosovës në mekanizmat e nivelit Evropian.

## **6. Revistat “Kërkime” nr.20 dhe 21**

Kërkime është revistë shkencore të cilën e boton Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm nga fusha e shkencave që i përkasin Seksionit të SHN , vlerësime të veprave, vështrime dhe recensione, të cilat nuk janë botuar më parë. Të gjitha punimet i nënshtrohen vlerësimit profesional për të konstatuar se i plotësojnë kriteret shkencore për botim.

Pranimin e punimit për botim e bën Këshilli redaktues në bazë të recensioneve pozitive.

Revista botohet çdo vit.